

Në bazë të nenit 162 pika 3, 164, 166, 170 pika 3, 172 dhe 175 të Ligjit për arsimin e lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 82/2018) dhe Rregullores për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për përzgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore-profesionale, shkencore dhe mesimore dhe për thirje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore – shkencore dhe një bashkëpunëtor profesional pranë Fakulteteve të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

Shpallet Konkurs për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore – shkencore dhe të një bashkëpunëtor profesional në:

A. Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

A.1 Programi studimor: ARKITEKTURË DHE DIZAJN

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në fushën arsimore – shkencore **KONSTRUKSIONE ARKITEKTONIKE** (20112 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit).
2. Zgjedhje të një mësimdhënësi në fushën arsimore – shkencore **PROJEKTIME ARKITEKTONIKE DHE DIZAJN** (20100 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit).

A.3 Programi studimor: GJEODEZIA DHE GJEONFORMATIKA

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në fushën arsimore – shkencore **GJEODEZI E APLIKUAR** (20602) dhe **TJETËR** (20609) nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.)

B. Fakulteti i shkencave teknologjike pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

B.1 Programi studimor: TEKSTIL, DIZAJN DHE MODELIM

1. Zgjedhje të një bashkëpunëtor profesional për lëndët profesionale – artistike nga sfera **DIZAJNIMI I TEKSTILIT DHE VESHJEVE** (22304 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit) dhe **TEKSTIL** (60707 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit).

Kushtet dhe kriteret për zgjedhje:

Kandidatët përveç kushteve të përgjithshme, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet dhe kriteriumet e parapara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Rregullores për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për përzgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore-profesionale, shkencore dhe mesimore dhe për thirje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Kandidatët obligohen të dorëzojnë dokumentet në vijim: fletparaqitje për konkurs, biografi të shkurtër, dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta, listë të publikimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të të njejtave, Vendim nga zgjedhja e mëparshme në thirjen mësimore shkencore.

Orari i punës do të përcaktohet në përputhje me fondin e orëve dhe aktet e Universitetit.

Shuma e pages neto për pozicionet e shënuara është në përputhje me aktet e Universitetit, angazhimit mësimor të mësimdhënësit gjatë semestrit dhe thirjes mësimore shkencore në të cilën është bërë përzgjedhja dhe do të arrin prej 22.539 deri 34.446 denarë.

Konkursi zgjat **shtatë (5) ditë pune nga dita e shpalljes.**

Fletparaqitjen me dokumentet e nevojshme kandidatët duhet t'i dorëzojnë në hapësirat e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rr. “12-ta Udhëtarë” nr. 2-a/ te INFO QENDRA në katin përdhësë, me shënimin: Për konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirjet mësimore shkencore edhe atë në:

A.Fakultetin e ndërtimtarisë dhe arkitekturës

B. Fakultetin e shkencave teknologjike

Pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

Dokumentet jo të plota dhe ato që nuk do të dorëzohen në kohë nuk do të merren parasysh.

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup